

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A LUSHNJË**

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Ujësjetellës Kanalizime” SH.A Lushnjë me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe mjedisore” për periudhën e veprimtarisë nga data 01.05.2013 deri me datë 31.08.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 172, datë 28.12.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 801/6, datë 28.12.2015, dërguar z. Albert Divjaka, Drejtor në “Ujësjetellës Kanalizime” SH.A Lushnjë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

#### **I. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, u konstatua që:**

##### **1. Gjetje nga auditimi:**

-Për periudhën objekt auditimi, Këshilli Mbikëqyrës nuk ka pasur në përbërjen e tij specialist të fushës së ekonomisë apo financës, veprim në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 4/b ku citohet se “Njëri nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës duhet të jetë specialist në fushën e ekonomisë dhe të financës”.

-Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjet e tij, nuk ka mbajtur regjistër të pjesëmarrjes së anëtarëve në mbledhje, i cili duhet të nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët pjesëmarrës, veprim ky në kundërshtim me pikën 8, neni 20, të VKM nr. 678, datë 03.10.2007, për një shtesë në VKM nr. 271, datë 09.05.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore”.

-Shoqëria “Ujësjetellës Kanalizime” SH.A Lushnjë, nuk ka hartuar Rregulloren “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetellës-kanalizimeve”, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1304 datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetellës-kanalizimeve sh.a” (Trajtuar më hollësisht në faqet 25-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

##### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Nga Asambleja e Aksionarëve të merren masa që Këshilli Mbikëqyrës në përbërjen e tij, të ketë specialist të fushës së ekonomisë apo financës, në zbatim të VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 4/b.

***Brenda datës 31.03.2016***

-Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masa që pjesëmarrja e anëtarëve në mbledhje të evidentohet në një regjistër, në zbatim të pikës 8, neni 20, të VKM nr. 678, datë 03.10.2007, për një shtesë në VKM nr. 271, datë 09.05.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore”.

***Menjëherë dhe vazhdimisht***

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të zbatohen procedurat ligjore, për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetellës-kanalizimeve sh.a”.

***Brenda datës 31.03.2016***

## **2. Gjetje nga auditimi:**

-Ish-kryetari i Këshillit Mbikëqyrës Bujar Çela, pa kompetencë ligjore ka zbardhur dhe nënshkruar vendimet e Këshillit Mbikëqyrës nr. 7, 8, 9, 10 dhe 11 të datës 27.12.2013, pa u mbledhur këshilli mbikëqyrës, si dhe vendimin nr. 13 të datës 22.08.2014 "Mbi emërimin e administratorit të shoqërisë "Ujësjetllës Kanalizime" Lushnje, pa pasur kuorumin e mjaftueshëm të votave për të marrë vendime të vlefshme në përputhje me rendin e ditës, fakt i provuar (vërtetuar) nga libri i protokollit, i cili është nënshkruar vetëm prej tij. Për pasojë këto vendime janë akte administrative absolutisht të pavlefshme.

Veprime në kundërshtim me Ligjin 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 116 "Aktet administrative absolutisht të pavlefshme", Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, neni 167, pika 5 dhe neni 162, pika 1 "Vendimet e këshillit të administrimit vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dya e anëtarëve.", pikën 7, neni 20 të statutit të shoqërisë të miratuar me VKM nr. 678, datë 03.10.2007, për një shtesë në VKM nr. 271, datë 09.05.1998 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore" ku citohet se "Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm, në qoftë se janë të pranishëm jo më pak se katër anëtarë të tij", Udhëzimi i Ministrit të METE-s nr. 318, datë 08.04.2009 "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore" paragrafi III, pika 5, ku përcaktohet "Zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës dokumentohet në librin e protokollit nga sekretari i këshillit mbikëqyrës. Mbi bazën e protokollit të mbajtur zbardhen vendimet e këshillit mbikëqyrës." dhe në kundërshtim me pikën 18, paragrafi III i Udhëzimit nr. 965, datë 11.12.2007 Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave "Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjetllës-kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore", ku citohet se "Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm, në qoftë se janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij."

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur më sipër ngarkon me përgjegjësi ....., me detyrë ish-Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës (Trajtuar më hollësisht në faqet 25-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Nga Këshilli Mbikëqyrës, të rishqyrtohen vendimet nr. 7, 8, 9, 10 dhe 11 të datës 27.12.2013, si dhe vendimi nr. 13, i datës 22.08.2014, të cilat janë marrë pa pasur kuorumin e mjaftueshëm të votave për të marrë vendime të vlefshme në përputhje me rendin e ditës, fakt i provuar (vërtetuar) nga libri i protokollit, të merret vendimi përkatës dhe të miratohet në asamblenë e aksionarit (këshillin bashkiak).

*Menjëherë*

## **II. Nga auditimi mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e programit ekonomik-financiar në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet eprore, si dhe realizimi i tij, u konstatua që:**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

-Nga Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime" SH.A Lushnjë, nuk është aplikuar llogaritja e kamatëvonesave për mos likuidimin e faturave të ujit (si për ato që nuk janë likuiduar asnjë herë, të likuiduar pjesërisht, ose që nuk janë likuiduar në kohën e duhur). Konkretisht gjendja debitoare nga mos arkëtimi i faturave të ujit të pijshëm më datë 31.08.2015 paraqitet në **11,999 raste në vlerën 227,637,284 lekë**. Kjo gjendje debitoare nuk ka përfshirë llogaritjen e kamatëvonesave në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 Për miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës-kanalizimeve", Ligjit nr. 8102, datë 28.3.1999 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar,

Udhëzimit nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, i ndryshuar, ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, me ndryshimet përkatëse "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" i ndryshuar, duke shkaktuar **të ardhura të munguara për shoqërinë në vlerën 22,763,728 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 38-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të analizohet vlera **22,763,728 lekë**, që përfaqëson kamatëvonesa për mos likuidimin në kohë ose jo të faturave të ujit të pijshëm, si dhe të merret vendimi përkatës për arkëtimin e kësaj vlere, pasi kjo përbën një të ardhur të munguar për Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lushnjë.

*Brenda datës 31.03.2016*

#### **2. Gjetje nga auditimi:**

Asambleja e Aksionarëve dhe Këshilli Mbikëqyrës, nuk kanë analizuar shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në humbjet e kësaj shoqërie, si dhe nuk kanë marrë masat e nevojshme për të mundësuar drejtimin e shoqërisë drejt rezultateve pozitive.

-Drejtoria e shoqërisë, nuk ka bërë një analizë të hollësishtme të kostove operative, për të identifikuar mundësitë për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve, si dhe të uljes së çmimit për m<sup>3</sup> ujë të prodhuar dhe të shitur.

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, nuk ka hartuar planin strategjik për zvogëlimin e humbjeve të ujit për periudhën 2013, 2014 dhe 2020. Ky plan duhet të përmbajë objektiva dhe masa konkrete, që duhet të ndërmerren nga shoqëria për eliminimin e humbjeve të ujit të pijshëm, plan i cili duhet të realizohet deri në fund të vitit 2020.

-Nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, nuk është bërë bilanci i ujit (analiza e humbjeve teknike dhe ekonomike menaxheriale). Në programet ekonomike të vitit 2013, 2014 dhe 2015, humbjet nuk janë parashikuar të detajuara në humbje teknike dhe ekonomike (menaxheriale).

Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, nuk ka bërë një plan të detajuar për numrin e konsumatorëve që nuk janë të pajisur me matës uji, duke përcaktuar afatin konkret të pajisjes së tyre 100 përqind me matës (Trajtuar më hollësisht në faqet 38-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, të marrë masa që treguesit e prodhimit të ujit dhe harxhimit të energjisë elektrike të mbahen në mënyrë analitike dhe jo sintetike, me synimin që prodhimi i ujit të përputhet me konsumin e energjisë elektrike (Të jenë në korrelacion të drejtë midis tyre).

*Menjëherë dhe Vazhdimisht*

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, të hartojë dhe të miratojë një plan biznesi pesëvjeçar, ku të jenë pasqyruar tarifat e reja në 5-vitet e ardhshme. Mbi bazën e këtij plan biznesi, duhet të zbatohet procedurat ligjore të miratimit të tarifave të reja të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, si dhe tarifave të tjera.

*Brenda datës 31.03.2016*

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të kostove operative për të identifikuar mundësitë për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve.

*Menjëherë dhe Vazhdimisht*

-Asambleja e Aksionarëve dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizojnë shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në humbjet e kësaj shoqërie, si dhe të marrin masat e nevojshme për të mundur drejtimin e shoqërisë, drejt rezultateve pozitive.

***Brenda datës 31.01.2016***

-Drejtorja e shoqërisë, të bëjë një analizë të hollësishme të kostove operative për të identifikuar mundësitë, për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve, si dhe të uljes së çmimit për m<sup>3</sup> të ujit të prodhuar dhe të shitur.

***Brenda datës 31.03.2016***

-Shoqëria “Ujësjetës Kanalizime” sh.a Lushnjë, të hartojë planin strategjik për zvogëlimin e humbjeve të ujit për periudhën 2016-2020. Ky plan të përmbajë objektiva dhe masa konkrete që duhet të ndërmerren nga shoqëria për eliminimin e humbjeve të ujit, plan i cili duhet të realizohet deri në fund të vitit 2020.

***Brenda datës 31.03.2016***

-Nga Shoqëria “Ujësjetës Kanalizime” sh.a Lushnjë për vitin 2016, të bëhet bilanci i ujit, analiza e humbjeve teknike dhe ekonomike (menaxheriale). Në programin ekonomik të vitit pasardhës, humbjet të parashikohen të detajuara në humbje teknike dhe ekonomike (menaxheriale).

***Brenda datës 31.03.2016***

-Shoqëria “Ujësjetës Kanalizime” sh.a Lushnjë, të bëjë një plan të detajuar për numrin e konsumatorëve që nuk janë të pajisur me matës, duke synuar që brenda vitit 2016, të bëhet pajisja 100 përqind e tyre.

***Brenda datës 30.04.2016***

### **3. Gjetje nga auditimi:**

-Shoqëria “Ujësjetës Kanalizime” sh.a Lushnjë, nuk ka bashkëpunuar me Njësitë Vendore, Zyrat e gjendjes civile, OSHEE-në, Drejtorinë Rajonale të Tatim-Taksave Fier, për të përditësuar të dhënat për numrin e familjeve, enteve private, enteve shtetërore dhe industrisë, në juridiksion të Shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime” sh.a Lushnjë, dhe mbi bazën e këtyre të dhënave të bënte programimin e faturimit dhe arkëtimit të ujit për vitin 2013, 2014 dhe 2015. Shoqëria “Ujësjetës Kanalizime” sh.a Lushnjë, nuk ka bërë evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve, duke koordinuar punën me sektorët përkatës, për debitorët që nuk likuadojnë detyrimet përkatëse të operohet në zbatim të Ligjit nr. 8975 datë 21.11.2002 ”Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, i ndryshuar.

-Shoqëria “Ujësjetës Kanalizime” sh.a Lushnjë, nuk ka kryer plotësisht transparencën ndaj klientëve, në lidhje me ankesat që kanë për mbi faturimet, verifikimin e matësit të ujit, duke i trajtuar konform dispozitave ligjore për ankesat.

-Shoqëria “Ujësjetës Kanalizime” sh.a Lushnjë, nuk ka përcaktuar tarifën e prerjes, tarifën e rilidhjes, tarifa e vulosjes së matësit dhe e penalteteve të tjera, tarifa të cilat duhet të përmirësonin faturën e ujit.

-Rregullorja brendshme e shoqërisë e miratuar në vitin 2007, nuk ka të përcaktuar procedurën që ndiqen për konstatimin, dokumentimin dhe ekzekutimin e kundravajtjes administrative. Konkretisht: Llojet e kundravajtjes administrative, akt konstatimi, hartimi i procesverbaleve masa e gjobës respektive, regjistrimi i gjobave, zyrat ku depozitohet gjoba, procedura për arkëtimin e gjobës etj, si dhe nuk ka rregullore të veçantë për konstatimin, dokumentimin dhe ekzekutimin e kundravajtjes administrative (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Nga Administratori i Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, të merren masa për bashkëpunim me Njësitë Vendore, Zyrat e gjendjes civile, OSHEE-në, Drejtorinë Rajonale të Tatim-Taksave Fier, për të përditësuar të dhënat për numrin e familjeve, enteve private, enteve shtetërore dhe industrisë, në juridiksion të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, dhe mbi bazën e këtyre të dhënave të programohet faturimi dhe arkëtimi i ujit për vitin 2016.

***Brenda datës 31.01.2016***

-Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa konkrete për evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve, duke koordinuar punën me sektorët përkatës, për debitorët që nuk likuidojnë detyrimet përkatëse të operohet në zbatim të Ligjit nr. 8975, datë 21.11.2002 ”Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”.

***Menjëherë dhe Vazhdimisht***

-Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për rritjen e transparencës ndaj klientëve, në lidhje me ankesat që kanë për mbi faturimet, verifikim të matësit të ujit etj, duke i trajtuar konform dispozitave ligjore për ankesat.

***Menjëherë dhe Vazhdimisht***

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa për të përcaktuar tarifën e prerjes, tarifën e rilidhjes, tarifën e vulosjes së matësit dhe të penaliteteve të tjera, tarifa të cilat duhet të përmirësojnë faturën e ujit.

***Brenda datës 31.03.2016***

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa për hartimin e një rregullore të veçantë për konstatimin, dokumentimin dhe ekzekutimin e kundravajtjes administrative si: Akt konstatimi, hartimi i procesverbaleve, vendosjen e gjobave, regjistrimi i gjobave, zyrat ku depozitohet akt konstatimi, gjoba, si dhe procedurat për arkëtimin e gjobave etj.

***Brenda datës 31.03.2016***

**III. Nga auditimi mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, u konstatua që:**

**1. Gjetje nga auditimi:**

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë për vitet 2013, 2014 dhe 2015, nuk ka miratuar nivelin e pagave nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja a, ku citohet se organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50% shtetëror, miratojnë :a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës (*Trajtuar më hollësisht në faqet 52-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të merren masa për miratimin e nivelit të pagave nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, në zbatim të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja a.

***Brenda datës 31.01.2016***

## **2. Gjetje nga auditimi:**

-Për vitet 2013, 2014 dhe 2015, si rezultat i zgjidhjes të kontratës së punësimit (largimet nga puna), pa shkaqe të arsyeshme, “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë është penalizuar nga vendimet e gjykatave në 8 raste në shumën **2,809,909 lekë**, nga të cilat është disbursuar shuma totale prej 2,809,909 lekë.

-Shoqëria nuk disponon një procedurë ose rregullore të përcaktuar për rekrutimin e punonjësve, si edhe nuk ka gjurmë në asnjë rast në burimet njerëzore, për nevojat e sektorëve apo drejtorive (*Trajtuar më hollësisht në faqet 52-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbartimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

***Menjëherë dhe Vazhdimisht***

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të hartohet rregullorja e përcaktimit të kriterëve të punësimit, sipas pozicionit të vendeve të punës dhe të merren masa për zbatimin korrekt në rekrutimin apo lëvizjen e punonjësve.

***Brenda datës 31.03.2016***

***IV. Nga auditimi mbi mbajtjen e evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit, u konstatua që:***

### **1. Gjetje nga auditimi:**

-Të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 60-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të zbatohen procedurat ligjore nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, për të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet.

***Brenda datës 31.12.2016***

## **2. Gjetje nga auditimi:**

-Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë. Megjithatë nga organet drejtuese të saj nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre. Konkretisht gjendja debitore është në vlerën 208.676.237 leke për vitin 2013, në vlerën 221.799.839 lekë për vitin 2014. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme në masën 97 % për vitin 2013 dhe 98% për vitin 2014, e zënë klientët për shitje uji.

Nga verifikimi i llogarisë 411000 në kontabilitet për vitin 2013, kjo gjendje paraqitet në vlerën 202,385,161 lekë dhe në bilanc në vlerën 202,385,161 lekë, ndërsa për vitin 2014 kjo gjendje paraqitet 217,359,887 lekë e dhe në bilanc në vlerën 217,359,887 lekë.

Ndërsa gjendja kreditore është në vlerën 96.101.573 leke për vitin 2013, në vlerën 75.256.942 lekë për vitin 2014.

Duke ju referuar të ardhurave dhe shpenzimeve gjendja debitore zë respektivisht 172% për vitin 2013 dhe 161% për vitin 2014 të të ardhurave, ndërsa gjendja kreditore zë 71% për vitin

2013 , 54% për vitin 2014 të shpenzimeve (*Trajtuar më hollësisht në faqet 60-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Asambleja e Aksionarëve dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizojë gjendjen debitore dhe kreditore të shoqërisë Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” sh.a Lushnjë më datë 31.12.2015, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre.

*Brenda datës 31.01.2016*

## ***V. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua që:***

### **1. Gjetje nga auditimi:**

Ndërmjet shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a. Lushnjë, dhe shoqërisë ..... shpk të përfaqësuar nga ..... administrator i Shoqërisë ..... shpk në datën 14.10.2013 është lidhur aktmarrëveshja për “Financimin dhe Instalimin e një sistemi elektronik për matësit e ujit (EWMS) në qytetin e Lushnjës dhe Zonat përreth”, me vlerë 1,700,000 Euro, pa TVSH (Për Tvsh palët kanë rënë dakord që për çdo vlerë TVSh për situacionin përkatës do të paguhet brenda 20 muajve nga momenti i lëshimit dhe pranimin të situacionit të ndarë në shumën të barabarta për çdo muaj sipas aneksit nr. 3 të aktmarrëveshjes. Garancia për dy vjet, afati 12 muaj nga data e nënshkrimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se marrëveshja është lidhur dhe zbatuar në kundërshtim me dispozita ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën financiare, bankare, të liçensimit, të prokurimit dhe atë të ndërtimit, si dhe në kushte ekonomiko financiare të disfavorshme për shoqërinë (me humbje për vitet 2012, 2013, 2014 dhe e parashikuar me humbje për vitin 2015), si dhe me barrën e shlyerjes së kredive (dy kredi të tjera vetëm me pricipial 6,401,626 euro, pa përfshirë interesat), kjo shoqëri jo vetëm është në gjendjen e paafëtisë së paguese, por është plotësisht e falimentuar bile në rastin më të keq, të një falimenti të provokuar, nga organet drejtuese të saj (këshilli mbikëqyrës, këshilli bashkiak dhe administratori i shoqërisë).

Për këtë kontratë kredie, nga Kryetari i Bashkisë Lushnjë ..... në cilësinë e garantuesit, është lëshuar letër angazhimi nr. 3547 prot, datë 02.12.2013 me përfitues ..... sh.a, në të cilën përveç të tjerave citohet se “Bazuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Lushnjë nr. 4, datë 25.09.2013 merr përsipër dhënien e fondeve të nevojshme Uk Lushnjë për të realizuar pagesat e kërkuara nga ....., në rast se dështon në përmbushjen e detyrimeve ndaj bankës deri në limitin 1,070,000 euro, me të ardhurat e mbledhura pjesë e faturës së Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë”.

Bashkia Lushnjë nuk ka dërguar për miratim paraprak në Ministrinë e Financave këtë aktmarrëveshje, në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”, neni 3, pika 2, e cila përcakton se: “Hua” është një detyrim monetar apo çdo detyrim tjetër, që buron nga një marrëveshje financimi, emetim titujsh apo **garanci** për të tretë” dhe neni 7, pikat 5 dhe 6, të cilat përcaktojnë se: “5. Vendimi për huan afatgjatë hyn në fuqi pas konfirmimit nga Ministri i Financave. Ministri i Financave kufizohet vetëm në konfirmimin e përfundimtar të procedurave për autorizimin e huasë, në përfundim të kësaj nen dhe verifikimin e respektimit të kufizimeve të borxhit, të parashikuara në kreun IV të këtij ligji. Vlerësohet se Ministri i Financave e ka konfirmuar huan, në rast se nuk përgjigjet brenda njëzet ditëve nga data e marrjes së njoftimit, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Pavarësisht pikës 5 të këtij neni, huaja:

- a) e marrë për rifinancimin e një huaje tjetër;
- b) e marrë në tregjet ndërkombëtare;

c) e marrë nga një njësi e qeverisjes vendore, e cila ka pasur një rast të vështirësisë financiare, gjatë pesë viteve paraardhëse, është subjekt i miratimit të Ministrit të Financave”.

-Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 35, datë 05.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 ”Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore” dhe konkretisht: KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA, neni 21 -Huamarrja nga subjekti me kompetenca të përbashkëta ku përcaktohet se: “Njësia e qeverisjes vendore mund t'i delegojë një subjekti me kompetenca të përbashkëta të drejtën për të krijuar borxh. Ky subjekt merr hua dhe krijon borxh në përputhje me këtë ligj dhe marrëveshjen për krijimin e tij. Kufizimi i borxhit për llogari të njësisë së qeverisjes vendore, themeluese e këtij subjekti, është në proporcion me angazhimin e saj në këtë marrëveshje”.

Neni 4 “Qëllimi i huasë”, pika 3 përcaktohet se: “Njësia e qeverisjes vendore mund të lëshojë garanci në favor të subjekteve të kontrolluara prej saj për hua,që merren prej këtyre subjekteve, për financimin e shpenzimeve kapitale, që shërbejnë për një funksion të njësisë së qeverisjes vendore”.

Pika 4, ku përcaktohet se: “Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore dhe çdo person i autorizuar prej tij merr të gjitha masat e nevojshme apo të lidhura me marrjen e huasë. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore emeton titujt e njësisë së qeverisjes vendore, të cilat mund të jenë afatgjata ose afatshkurtra, si dhe hyn në negociata për marrëveshjet e huave të njësisë së qeverisjes vendore. Përzgjedhja e llojit të huas dhe huadhënësit nga njësia e qeverisjes vendore bëhet duke respektuar parimet e ekonomisë dhe eficiencës në përdorimin e burimeve publike”

Për pasojë mos dërgimi dhe mos miratimi i aktmarrëveshjes nga Ministria e Financave ka sjellë mos regjistrimin e saj në regjistrin e borxhit publik (Trajtuar më hollësisht në faqet 65-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Nga Administratori i Shoqërisë të prezantohet në Ministrinë e Financave marrëveshja e lidhur datë 14.10.2013 ndërmjet Shoqërisë “Ujësjellës kanalizime Lushnjë” sh.a Lushnjë dhe bashkimit të operatorëve ..... shpk & ..... shpk “Për Financimin dhe Instalimin e një sistemi elektronik për matësit e ujit (EWMS) në Qytetin e Lushnjës dhe zonat përreth”, me vlerë 1,700,000 EURO, pa TVSH, dhe të informohen organet drejtuese për gjendjen ekonomiko-financiare të shoqërisë (me humbje për vitet 2012, 2013, 2014 dhe e parashikuar me humbje për vitin 2015), si dhe me barrën e shlyerjes së kredive (dy kredi të tjera vetëm me pricipial 6,401,626 euro, pa përfshirë interesat), si pasojë e së cilës kjo shoqëri jo vetëm është në gjendjen e paaftësisë pagueuse, por është plotësisht e falimentuar bile në rastin më të keq, të një falimenti të provokuar nga organet drejtuese të sajë (këshilli mbikëqyrës, këshilli bashkiak dhe administratori i shoqërisë).

Organet drejtuese të shoqërisë të analizojnë shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në humbjet e kësaj shoqërie, si dhe të marrin masat e nevojshme për të mundësuar drejtimin e shoqërisë, drejt rezultateve pozitive.

*Menjëherë dhe Vazhdimisht*

### **2. Gjetje nga auditimi:**

Më datën 03.12.2013 është lidhur kontratë kredie (për lëshim letër garancie bankare), ndërmjet shoqërisë Ujësjellës Sha, Lushnjë përfaqësuar nga ..... dhe ..... përfaqësuar nga ..... në cilësinë e drejtorit të Filialit Tirana 6, me objekt “Banka më anë të kësaj kontrate kredie për lëshimin e letër-garancie bankare i jep (akordon) kredimarrësit një kredi në shumën 1,070,000 euro, me vlefshmëri maksimale 72 mujore në favor të përfituesit/sipërmarrësit ..... shpk, në kuadër të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a. Lushnjë dhe shoqërisë .....shpk të përfaqësuar nga ..... & shoqërisë ..... shpk në datën 14.10.2013, është lidhur



aktmarrëveshja për "Financimin dhe Instalimin e një sistemi elektronik për matësit e ujit (EWMS), me 72 këste me interesa të kalkuluar 4.5 % në vit, kohëzgjatja e kredisë 6 vite, numri i kësteve në vit 12, me datë fillimi të kredisë 01.01.2014, me shumë totale interesi 168,589 lekë.

Në kontratën e kredisë të lidhur datë 03.12.2013, pika 14 "Tarifat dhe Komisionet Bankare" përcakton se: "...Kredimarrësi i detyrohet bankës një komision total (çelje kredie+komision lëshim garancie+trasnferta swift) prej 2.4% të shumës totale të llogaritur mbi garancinë bankare prej 1'070'000 euro. ....Komisioni për lëshimin e letër garancisë bankare do të paguhet në dy këste të barabarta gjashtëmuajore.

Në përputhje me kushtet e punës së bankës për të cilat kredimarrësi ka marrë dijeni të plotë dhe i ka pranuar ato pa asnjë rezervë, kredimarrësi pranon që komisioni për lëshimin e letër-garancisë bankare është në bazë vjetore dhe i llogaritur mbi shumën maksimale të garancisë bankare dhe do të paguhet rregullisht çdo vit deri në datën e fundit të vlefshmërisë së garancisë bankare".

Komision në total (çelje kredie+komision lëshim garancie+trasnferta swift) prej 2.4% , duhet të ishte llogaritur sipas një plan amortizimi në momentin e lidhje së kontratës së kredisë (për lëshim letër garancie bankare). Pra për çdo vit shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime" Sha, Lushnjë duhet të paguaj në favor të ....., 2.4 % të vlerës së mbetur të shlyerjes së principialit të kredisë dhe jo 2.4 % të shumës totale në vlerën 1,070,00 euro, siç përcaktohet në pikën 14 "Tarifat dhe Komisionet Bankare" të kontratës.

Sipas shlyerjes në fakt të komisionit deri në 23.11.2015, datë në cilën përfundoj auditimi, detyrimi i shoqërisë për gjithë periudhën "Ujësjetllës Kanalizime" Sha, Lushnjë për Veneto ..... shkon në vlerën 111,762 euro.

Deri në momentin e auditimit janë paguar në favor të ..... vlera 50,427 euro (Trajtuar më hollësisht në faqet 65-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Nga Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtohet kontrata e kredisë e lidhur datë 03.12.2013 ndërmjet shoqërisë "Ujësjetllës Kanalizime" Sha, Lushnjë përfaqësuar nga ..... dhe ....., si dhe të merret vendimi përkatës për zbatimin e saj konform legjislacionit përkatës.

-Nga Administratori i Shoqërisë të negociohet me ..... për të saktësuar pikën 14 "Tarifat dhe Komisionet Bankare" të kontratës së kredisë të lidhur datë 03.12.2013 ndërmjet shoqërisë "Ujësjetllës Kanalizime" Sha, Lushnjë përfaqësuar nga ..... dhe ....., për sa i përket komisionit (çelje kredie+komision lëshim garancie+trasnferta swift) prej 2.4%, komisioni i cili duhet të likuidohet në favor të ..... sipas një plan amortizimi (2.4% të vlerës së mbetur të shlyerjes së principialit të kredisë dhe jo 2.4 % të shumës totale prej 1,070,00 euro).

***Brenda datës 31.01.2016***

### **3. Gjetje nga auditimi:**

Në përcaktimin e fondit limit, nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si dhe çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, janë mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga Autoriteti Kontraktor, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", neni 59 "Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës".

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e

Prokurimit Publik, të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, *i ndryshuar me VKM nr. 914 datë 29.12.2014* “Rregullat e Prokurimit”.

-Specifikimet teknike nuk janë hartuar plotësisht në përputhje me nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ato nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatimi ose tipi, origjinë specifike, prodhuesi ose sipërmarrje shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkimit të kërkesave, me kusht që fjalët “*ose ekuivalent*” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për shkaqet subjektive që vërehen në procedurat e anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit. Autoriteti kontraktor publikon njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është publikuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit për anulim.

-Në dy procedura tenderimi, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer *në mënyrë të padrejtë*, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në pesë procedura tenderimi, nuk është bërë çlirimi i sigurimit të ofertës pas lidhje së kontratës, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, neni 18 “Sigurimi i ofertës”.

-Në pesë procedura tenderimi, nuk është paraqitur nga ana e operatorëve fitues, polica e sigurimit, në kundërshtim me nenin 25.2 të kushteve të përgjithshme të kontratës, ku në mënyrë eksplicite citohet “Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit me aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion do të mbuloj kompensimin e kërkuar për të mbuluar humbjen e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti kontraktor, mund të vendos të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit, ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresë koston e tij, nga pagesa që i jep kontraktorit”.

-Në pesë procedura tenderimi, njësia e prokurimit ka miratuar dokumentet e tenderit, kërkesat për kualifikim, specififikimet teknike, ndërsa kriteret e vlerësimit nuk i ka përcaktuar.

-Në 1 raste dokumentacioni teknik i zbatimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit nuk është i plotë dhe i saktë, duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë dhe buxhetit të shtetit në *vlerën 326,250 lekë*.

-Në 1 raste dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve (motogenerator saldimi) nuk është i plotë dhe i saktë duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të shoqërisë

“Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë dhe buxhetit të shtetit *në vlerën 1,020,000 lekë* (Trajtuar më hollësisht në faqet 65-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Për një përdorim me efikasitet të fondeve publike të argumentohet domosdoshmëria e kryerjes së prokurimit me leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen;

- Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike. Këto kërkesa duhet të kenë në konsideratë edhe faktin që të kushtëzojnë kualifikimin e operatorëve në vartësi të shlyerjes/ose jo të detyrimeve financiare ndaj shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, zgjidhjes së njëanshme të kontratave, ose mos përmbushjes të të gjitha detyrimeve kontraktore. Ky rekomandim mbështetet në frymën e ligjit për prokurimin publik si dhe në rregullat e prokurimit publik.
- Nga Administratori i shoqërisë, t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente.
- Për të përcaktuar përgjegjësinë individuale, të bëhet ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe të miratohet nga titullari i Autoritetit Kontraktor.
- Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

*Menjëherë dhe Vazhdimisht*

## **VI. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatua që:**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

Në strukturën organizative të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk është organizuar dhe nuk funksionon njësi e auditit të brendshëm, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 345, datë 1.6.2004 “Për aprovimin e manualit të procedurave të Auditit të Brendshëm, mbi Kodin e Auditit të Brendshëm dhe mbi Auditimin e Brendshëm Publik”, seksioni II, pika 8 ku citohet “Shoqëritë anonime me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind detyrohen të ngrenë strukturën e auditimit sipas kriterëve të përcaktuara me sipër, e cila i raporton këshillit mbikëqyrës. Të gjithë auditet e këtyre shoqërive emërohen dhe shkarkohen nga Këshilli Mbikëqyrës” (Trajtuar më hollësisht në faqet 107-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masa që në strukturën organizative të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, të jetë organizuar dhe të funksionojë Njësia Auditit të Brendshëm, në zbatim të VKM nr. 345, datë 1.6.2004 “Për aprovimin e manualit të

## **2. Gjetje nga auditimi:**

### **Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.**

-Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, nuk është realizuar, kjo në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi edhe nga Ministria e linjës nuk është kërkuar që ky detyrim dhe në zbatim të ligjit të MFK, nga shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë të dërgohej pranë kësaj Ministrie “Pyetësori i vetëvlerësimit”.

Në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk është implementuar asnjë procedurë në lidhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nuk janë caktuar sipas kërkesave të ligjit, as nëpunësi autorizues dhe as nëpunësi zbatues, veprimtaria menaxheriale ka funksionuar vetëm duke zbatuar ligjin për shoqëritë dhe sipas rregullores së brendshme të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës në datën 21.01.2008, dhe për rrjedhojë:

- Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk ka caktuar koordinatorin e riskut, nuk ka hartuar regjistrin ose raportin e përgjithshëm të risqeve.

- Nuk është realizuar deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010.

- Nuk është përcaktuar dhe miratuar strategjia, nuk janë përcaktuar objektivat strategjike për secilin funksion, politikat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, plani i zhvillimit, të cilat duhet të ishin të shoqëruara me plan-veprime dhe objektiva për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse.

- Për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nuk ka urdhër të Administratorit për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS).

- Rregullorja e shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, nuk parashikon me hollësi dhe saktësi të gjitha detyrat dhe funksionet e stafit të shoqërisë sipas strukturës së miratuar.

- Nuk janë miratuar rregullore/udhëzime të brendshme në lidhje me etikën, konfliktin e interesit, marrëdhëniet midis menaxherëve, marrëdhëniet me të tretët, etj.

- Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe operacionet e njësive publike.

- Nuk ka politika për menaxhimin e burimeve njerëzore, pasi mungon një Rregullore, ku janë përcaktuar detyrat e sektorëve dhe linjat e raportimit. Nuk ka të miratuar përkrahje të detyrave individuale. Nuk ka vlerësime periodike të punonjësve lidhur me detyrat që kryejnë ato. Nga Administratori, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit.

- Nuk janë përcaktuar prioritetet në secilën fushë, ku shtrin veprimtarinë shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, të cilat duhet të jenë përcaktuar sipas sektorëve.

- Nuk ka të përcaktuar një plan vjetor me tematikat që do të zhvillohen gjatë vitit, apo plan-veprime 3-mujore nga çdo sektor në bazë të rendit të ditës së mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës. Gjithashtu në Rregullore duhet të jenë përfshirë tregues të performancës, instrumente monitorues dhe rregulla për raportimin e aktivitetit.

- Nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave.

- Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë nuk ka një procedurë të shkruar (udhëzues rregullativ) për mënyrën e komunikimit shkresor brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit, e cila duhet të ishte pjesë e rregullores së brendshme (*Trajtuar më hollësisht në faqet 107-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, të hartojë planin për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, planin strategjik, të përcaktojë objektivat, si dhe të hartojë planveprimet afatshkurtra për implementimin e Ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

***Brenda datës 31.03.2016***

-Në kuadrin e zbatueshmërisë të Ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010, të bëhen kualifikime e seminare për zbërthimin e ligjit, mënyrën e analizës së menaxhimit të riskut, për t’u njohur më mirë me konceptet e ligjit, si dhe komponentët e MFK për të gjithë menaxherët e shoqërisë, më qëllim implementimin dhe zbatimin sa më të mirë të tyre në praktikë.

***Vazhdimisht***

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masa për hartimin e Udhëzuesit rregullativ, të shkruar lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar, duke përcaktuar strukturat menaxheriale, nëpunësin autorizues, nëpunësin zbatues dhe përgjegjësitë përkatëse.

***Brenda datës 30.06.2016***

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masa për hartimin e rregullores së re, ku të implementohen sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm në zbatim të Ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”.

***Brenda datës 30.06.2016***

## **VII. Nga auditimi mbi zbatimin e standardeve shtetërore të ujit të pijshëm dhe të ujërave të ndotura, u konstatua që:**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

-Prodhimi dhe furnizimi me ujit të pijshëm i popullatës, biznesit, institucioneve dhe industrisë, nuk është kryer plotësisht në zbatim të standardeve shtetërore. Konkretisht nuk janë kryer analizat e përbërjes fiziko-kimike të ujit të pijshëm për çdo pus, për të përcaktuar trajtimin kimik të ujit të pijshëm, si dhe nuk janë kryer analizat të PH të ujit.

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, nuk ka realizuar plotësisht mbrojtjen hijeno-sanitare të rezervuarëve, depove të ujit dhe rrjetit shpërndarës deri tek përdoruesi, duke përcaktuar zonat e mbrojtura nr. 1,2,3, si dhe nuk janë pajisur me një leje nga autoriteti i basenit ujqor vendor, burimet që shfrytëzohen për qëllime pirje uji.

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, nuk ka planshetet e magjistraleve kryesore, dytësore dhe terciare terciare të furnizimit me ujë të pijshëm.

-Në këtë shoqëri, nuk ka rregullore (metodikë) të kryerjes nga laboratorit të analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm.

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, nuk ka planshetet e shkarkimit të ujërave të ndotura, primare dhe sekondare.

-Nga kjo shoqëri, nuk është kryer monitorimi i shkarkimeve të ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale, si dhe nuk është kryer asnjë analizë ujërave të ndotura, për pasojë nuk mund të gjykohet për zbatimin e standardeve shtetërore.

-Nga kjo shoqëri, nuk është mbajtur ditari i regjistrimit të të dhënave të prodhimit të grumbullimit, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura urbane, komerciale dhe industriale.

-Nga kjo shoqëri, nuk është mbajtur regjistri i ujërat të ndotura që nuk mund të shkarkohen në sistemin publik të kanalizimeve (komerciale dhe industriale), vend mbajtja e tyre dhe largimi në mënyre legale dhe të autorizuar, si dhe regjistri i heqjes së llumit nga gropat septike, gropat e banjave, dhe procedura e ndjekur sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU-ja (*Trajtuar më hollësisht në faqet 119-121, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Të merren masa nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, që prodhimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm i popullatës, biznesit, institucioneve dhe industrisë, të kryhet në zbatim të standardeve shtetërore të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës-kanalizimeve sh.a” dhe VKM nr. 145, datë 26.02.1988 “Për miratimin e rregullores higjieno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”.

***Urgjent***

-Të merren masa nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, për të realizuar plotësisht mbrojtjen higjieno-sanitare të rezervuarëve, depove të ujit dhe rrjetit shpërndarës deri tek përdoruesi, në zbatim të Ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës-kanalizimeve sh.a” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zoonimit të mjediseve ujore pritëse”.

***Urgjent***

-Të merren masa nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, për monitorimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale, si dhe të kryhen analizat e ujërave të ndotura, në zbatim të standardeve shtetërore të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës-kanalizimeve sh.a”, Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zoonimit të mjediseve ujore pritëse” dhe Ligjit nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”.

***Menjëherë dhe Vazhdimisht***

-Të merren masa nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, për të mbajtur regjistrin shkrimor dhe elektronik të ujërat të ndotura, që nuk mund të shkarkohen në sistemin publik të kanalizimeve (komerciale dhe industriale), vend mbajtjen e tyre dhe largimin në mënyre legale dhe të autorizuar, si dhe regjistrin e heqjes së llumit nga gropat septike, gropat e banjave, duke zbatuar procedurat e përcaktuar sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU-ja.

***Menjëherë dhe Vazhdimisht***

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

-Bashkimi i shoqërive ..... shpk & Shoqërisë ..... shpk kanë filluar zbatimin e kontratës në datë 06/01/2014, fakt i provuar me procesverbalin mbi fillimin e punimeve, ***pa siguruar me parë të*** gjitha licencat sipas pikës 6 dhe pikës 11 (i), (iii) të aktmarrëveshjes e cila citon “Kjo marrëveshje mund të përfundojë në rastet e mëposhtme në përputhje dhe me pikën 10.2. (i) nëse P1, nuk nxjerr të gjitha licencat e nevojshme administrative apo

dokumente të tjerë që kërkohen për projektin, (iii) do të quhet shkelje e kontratës, nëse P1 nuk arrin të koeprojë dhe të krijojë të gjithë lehtësirat e nevojshme për kryerjen e punës sipas pikës 6 për më shumë se 30 ditë .

Deri më datën 23.11.2015 në UK Lushnjë janë instaluar 4500 matës elektronik. Për këto matës, edhe pse matja e ujit dhe likuidimi nga konsumatorët kryhet nëpërmjet tyre, ***nuk janë lidhur kontratat me konsumatorët***, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, akteve ligjore dhe nënligjore në funksion të tij, si dhe nuk është likuiduar në asnjë rast matësi i ujit elektronik.

Referuar-VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjellës Kanalizimeve sh.a”, pika 2.7.3, e cila përcakton se: “Ujëmatësit dhe saraçineskat e instaluara në objekte janë në pronësi të pronarit të objektit/apartamentit, i cili është përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre”, si dhe pika 2.8.5, e cila përcakton se: “Lidhja e çdo lloj pajisjeje konsumi të sistemit të brendshëm në mjedisin privat të konsumatorit bëhet me shpenzimet e vetë konsumatorit”, dëmi ekonomik i shkaktuar UK Lushnjë dhe buxhetit të shtetit është në vlerën 648,000 euro (4500 matës x 120euro/matës =540,000 euro x 1.2 TVSh = 648,000 euro. Mos pagesa e matësit elektronik është në kundërshtim vendimin e këshillit mbikëqyrës nr. 4, datë 25.09.2013 pika 3, e cila në mënyrë eksplicite citon “Të garantoj investimin dhe marrëveshjen e mësipërme me të ardhurat e mbledhura pjesë e faturës së ujësjellës Kanalizime Lushnjë.

#### ***Për pos sa më sipër,***

Edhe pse është paraqitur në situacionet, zëri matës dixhital të ujit (DWM), të pajisura me një valvul ndërprerje, të kontrolluara nga distanca në vlerën 540,000 euro, kjo vlerë nuk është e saktë, pasi në teren janë vendosur vetëm matësit elektronik të ujit dhe jo pajisje transmetimi (DCU).

Referua marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve, matësit elektronikë sipas strukturës së paraqitur nënkuptojnë matës+pajisje transmetimi (DCU) vlera 120 euro.

Pra për 4500 copë matës te vendosur, duhet të ishin të kompletuar me pajisje transmetimi (DCU), dhe pastaj të pasqyroheshin në situacionin me vlerën 450,000 euro pa tvsh.

Për pasojë nga vlera 648,000 eruro (540,000 euro x 20 % TVSH =648,000) nuk mund të përcaktohet sa është vlera e pa kryer, pasi në marrëveshje nuk ka të ndar sa janë matësit elektronik dhe sa janë pajisjet e transmetimi (DCU) (*Trajtuar më hollësisht në faqet 107-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga administratori i shoqërisë të zbatohen procedurat ligjore për kompletimin e matësve dixhital të ujit (DWM), ***si dhe të analizohet vlera 648,000 euro***. Kjo vlerë ka të bëjë me instalimin e 4500 matës elektronik nga shoqëria ..... deri në datën 23.11.2015, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjellës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetit të shtetit, ***përbën dëm ekonomik***.

***Deri në përfundim të projektit***

## **2. Gjetje nga auditimi:**

Nga shoqëria ..... shpk deri në datën 23.11.2015, për punimet e paraqitura në situacione me gjithë interesat e përditësuara është në vlerën 1,220,448 euro, ndërsa është likuiduar vlera 206,400 euro (172,000.00 euro x 20 % TVSH = 206,400 euro ( principal+interesa) ose në lekë 28,874,520 lekë (24,062,100 Lekë x 20 % tvsh =28,874,520 lekë).

Në mënyrë të detajuar si më poshtë vijon

Nr.	Përshkrimi i artikullit	Njësia	Sasia sipas situacionit	Çmimi njësi	Vlera sipas situacionit, pa tvsh
1	Matës dixhital të ujit (DWM), të pajisura me një valvul ndërprerje, të kontrolluara nga distanca	copë	4500	120	540,000
	Salla e kontrollit dhe menaxhimi i rrjetit			350,000	350,000
	Interesa			127,040.38	127,040.38
	<b>Shumatore</b>				<b>1,017,040.38</b>

Nga auditimi u konstatua se pajisjet e sallës së kontrollit dhe menaxhimi i rrjetit në vlerën 350,000 euro dhe matësit dixhital të ujit (DWM), të pajisura me një valvul ndërprerje, të kontrolluara nga distanca për vlerën 540,000, në total 1.017,000 euro pa tvsh x 20 % TVSH = **1.220.448 euro**, nuk janë të shoqëruar me dokumentacion si; Autorizim prodhuesi, test raporti i fabrikës, faturat e furnitorit, certifikatën e siguracionit, certifikata e garancisë, dokumentin e transportit (CMR) etj, listë paketim, deklaratë doganore, urdhër çlirim dogane etj, dhe të konfirmonte që këto pajisje janë të njëjta me ato të përcaktuar në marrëveshje (specifikimet teknike).

Ky dokumentacion nuk u vu në dispozicion edhe pse grupi i auditimit e ka kërkuar me shkresën nr. 136/2 prot, datë 09.11.2015 administratorit të shoqërisë.

Për pasojë Grupi i Auditimit, referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jepte opinion e Tij, për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve në vlerën **1.220.448 euro** (pajisjet e sallës së kontrollit dhe menaxhimi i rrjetit dhe Matësit dixhital të ujit (DWM), të pajisura me një valvul ndërprerje, të kontrolluara nga distanca) dhe të konfirmonte që këto pajisje janë të njëjta me ato të përcaktuar në aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet UK Lushnjë dhe bashkimit të operatorëve

**Shtuar dhe faktin që:**

**-1.** Matësit elektronik në trup kanë siglën e shoqërisë ..... shpk, shoqëri e cila ka hequr dorë nga realizimi i kontratës, me deklaratën noterial nr. 335 repertori, nr. 194 koleksioni, datë 24.01.2014 e firmosur nga shoqëritë ..... dhe ....., ku ndër të tjera është cituar se “..... ku do të saktësohet dhe cilësohet që ..... shpk, nuk do të jetë më pjesë dhe nuk do të ketë më asnjë detyrim kontraktual për kontratën në fjalë”.

**2.** Mbikëqyrësi i punimeve ing. ...., nuk ka zotësinë ligjore dhe profesionale për ti mbikëqyruar këto pajisje, pasi janë pajisje elektronike (*Trajtuar më hollësisht në faqet 107-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës, i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve, dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të përcaktuar në aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet UK Lushnjë dhe Bashkimit të operatorëve ..... (specifikimet teknike), si dhe të verifikojë gjendjen e tyre teknike pas vendosjes në punë, nëse kanë qenë ose jo problematike.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e instaluar nga shoqëria .....shpk nuk janë autentike, nuk janë të njëjta me ato të përcaktuar në aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet UK Lushnjë dhe Bashkimit të operatorëve .....shpk & ..... (specifikimet teknike), dhe gjendja e tyre teknike pas vendosjes në punë ka qenë problematike (defekte etj), **konsiderohet dëm ekonomik** dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **arkëtimi i vlerës 206,400 euro** nga shoqëria ..... shpk vlerë e likuiduar nga UK Lushnjë deri më 23.11.2015, ndërsa vlera 1,014,048 euro (1,220,448 -206,400= 1,014,048 ), që përfaqëson



punime të situacionuara por të pa likuiduara, të mos likuidohet. Kjo çështje do të verifikohet nga KLSH, në vijimësi në programet e zbatimit të rekomandimeve dhe në auditimin e radhës.

**Menjëherë**

### **3. Gjetje nga auditimi:**

-Me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 21 datë 24.12.2009, është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit të tubacioneve prej çeliku në vlerën kontabël 22,124,120 lekë. Nga vlerësimi u përllorarit sasia 6060 kg, sasi e cila pa procedurë ankandi ju shit si “Hekur skrap” Shoqërisë “Salliu” shpk për vlerën 96,960 lekë. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit”, i ndryshuar.

N.q.s do të ishte zhvilluar procedurë ankandi, referuar bursës EUROFER, e cila ka analizuar çmimet mesatare të bursave evropiane për çmimin e skrapit në Gjermani, Francë, Britani të Madhe, Itali dhe Spanjë rezulton se në periudhën Gusht 2010 çmimi mesatar i këtij produkti rezulton 283 euro/ton konvertuar sipas kursit të Bankës së Shqipërisë 137.0 lekë/euro = 38,771 lekë/ton, do të ishte krijuar një e ardhur në vlerën 235,029 lekë nga 96,992 lekë që është realizuar nga shitja me diferencë në vlerën 138,037 lekë.

Vlera 138,037 lekë përbënë dëm ekonomik për llogari të shoqërisë Ujësjiellës kanalizime sh.a Lushnjë dhe buxhetit të shtetit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 25-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të shqyrtojë **vlerën 138,037 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me mos zbatimin e procedurave të ankandit për nxjerrjen jashtë përdorimit të tubacioneve prej çeliku në sasinë 6060 kg me vlerë kontabël 22,124,120 lekë në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 21, datë 24.12.2009, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik” dhe VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit”, i ndryshuar. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjiellës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

**Brenda datës 31.03.2016**

### **4. Gjetje nga auditimi:**

Me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 21, datë 24.12.2009, është miratuar nxjerrje jashtë përdorimit të vlerave materiale, ku përfshin dhe tubacione çeliku me vlerë kontabël 22,124,120 lekë, e llogaritur në njësi fizike në sasinë 116.15 ton.

Referuar bursës EUROFER, e cila ka analizuar çmimet mesatare të bursave evropiane për çmimin e skrapit në Gjermani, Francë, Britani të Madhe, Itali dhe Spanjë, rezulton se në datën 30 Nëntor 2011 çmimi mesatar i këtij produkti është 175 euro/ton.

Sasia 116.15 ton tubacione është lënë në tokë, si pasojë e zëvendësimit të linjave të amortizuara me tubacione të reja, dhe nuk është ndërmarrë asnjë procedurë nga administratori dhe këshilli mbikëqyrës që tubacionet e zëvendësuara të nxirreshin dhe të shiteshin për skrap. Kjo sasi llogaritet në vlerën 20,326 euro (116.15 ton tubacione x 175 euro/ton = 20,326 euro). Vlera 20,326 euro përbënë dëm ekonomik për UK Lushnjë dhe buxhetin e shtetit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 25-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të shqyrtojë **vlerën 20,326 euro**. Kjo vlerë ka të bëjë me sasinë 116.15 ton me vlerë kontabël 22,124,120 lekë, tubacione prej çeliku të cilat janë lënë në tokë, si pasojë e zëvendësimit pjesor të tubacioneve të linjave të amortizuara me tubacione të reja, dhe nuk është ndërmarrë asnjë procedurë që tubacionet e

zëvendësuar të nxirreshin dhe të shitëshin për skrap, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjellës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetit të shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

*Brenda datës 31.03.2016*

#### **5. Gjetje nga auditimi:**

Me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 9, datë 19.12.2012, është miratuar nxjerrje jashtë përdorimit të vlerave materiale, ku përfshin dhe tubacione çeliku me vlerë kontabël në vlerën 8,186,700 lekë, e llogaritur në njësi fizike 71.7 ton.

Referuar bursës EUROFER, e cila ka analizuar çmimet mesatare të bursave evropiane për çmimin e skrapit në Gjermani, Francë, Britani të Madhe, Itali dhe Spanjë rezulton se në periudhën 04.12.2012, çmimi mesatar i këtij produkti rezulton 299 Euro/ton.

Sasia 71.78 ton tubacione është lënë në tokë, si pasojë e zëvendësimit pjesor të tubacioneve të linjave të amortizuara me tubacione të reja, dhe nuk është ndërmarrë asnjë procedurë nga administratori dhe këshilli mbikëqyrës që tubacionet e zëvendësuar të nxirreshin dhe të shitëshin për skrap. Kjo sasi llogaritet në vlerën **21.462 euro** (71.78 ton x 299 euro/ton= 21,462 euro).

Vlera 21,462 euro përbënë dëm ekonomik për UK Lushnjë dhe buxhetin e shtetit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 25-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtojë **vlerën 21,462 euro**. Kjo vlerë ka të bëjë me sasinë 71.78 ton me vlerë kontabël 8,186,700 lekë, tubacione prej çeliku të cilat janë lënë në tokë, si pasojë e zëvendësimit pjesor të tubacioneve të linjave të amortizuara me tubacione të reja, dhe nuk është ndërmarrë asnjë procedurë që tubacionet e zëvendësuar të nxirreshin dhe të shitëshin për skrap, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjellës kanalizime sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

*Brenda datës 31.03.2016*

#### **6. Gjetje nga auditimi:**

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Shitjes dhe Departamenti i Projekteve dhe Supervizionit u konstatua se në 39 pallate shumëkatëshe, vetëm për 18 janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të pijshëm duke paguar detyrimin financiar, ndërsa në 22 prej tyre nuk janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të pijshëm, pra lidhja nuk është e dokumentuar si është bërë (lidhje e paligjshme, lidhje me miratim verbal etj), duke i krijuar një dëm ekonomik shoqërisë “Ujësjellës kanalizime sh.a Lushnjë dhe buxhetit të shtetit në vlerën 660,000 lekë. Konkretisht pallatet që nuk kanë të dokumentuar pikat e lidhjes janë ..... me investitor ....., Pallat .....me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., .....me investitor ....., .....me investitor ....., Pallat me investitor ....., Pallat .....me investitor ....., Pallat .....me investitor ....., Pallat .....me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., Pallat .....me investitor ....., Pallat .....me investitor ....., Pallat ..... me investitor .....

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, Metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe

largimin e përpunimin e ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009, kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”, vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 27.03.2003 (Trajtuar më hollësisht në faqet 38-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i **vlerës 660,000 lekë**, për pallatet që nuk kanë të dokumentuar pikat e lidhje si:..... me investitor ....., Pallat .....me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., .....me investitor ....., .....me investitor ....., Pallat me investitor ....., Pallat .....me investitor ....., Pallat .....me investitor ....., Pallat .....me investitor ....., Pallat .....me investitor ....., Pallat .....me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., Pallat me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., Pallat .....me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., Pallat me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., .....me investitor ....., Pallat me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., .....me investitor ....., Pallat me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., Pallat ..... me investitor ....., vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjetllës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

***Brenda datës 30.06.2016***

#### **7. Gjetje nga auditimi:**

Nga verifikimit i kontratave familjare, të paguara në pallatet e reja shumëkatëshe u konstatua se në të 39 pallate shumë katëshe janë 1886 apartamente gjithsej, nga të cilat për 666 apartamente janë lidhur kontratat me abonentë që i shfrytëzojnë këto apartamente, 674 apartamente janë pa shitur në të cilët janë vendosur matësit e ujit, por nuk ka abonentë që i shfrytëzojnë, ndërsa 533 apartamente shfrytëzohen nga abonent të ndryshëm, faturohet dhe likuidohet uji i pijshëm, por janë të pa kontraktuar, pra nuk është lidhur kontratë me abonentin dhe nuk është paguar detyrimi në vlerën 8000 lekë për kontratë.

Pagesa në vlerën 8000 lekë mbështet në zbatim të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 27.03.2003. Në total detyrimi që nuk i është paguar UK Lushnjë **është në vlerën 9,656,000 lekë** (674 +533 =1207 x 8000 lekë/apartament = 9,656,000 lekë).

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, Metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009, kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”, vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 27.03.2003 (Trajtuar më hollësisht në faqet 38-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i **vlerës 9,656,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me 1207 apartamente në pallatet e reja shumëkatëshe për të cilat nuk janë lidhur kontratat e ujit të pijshëm, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjetllës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

*Në mënyrë të detajuar, aneksi nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Brenda datës 30.06.2016***

## **8. Gjetje nga auditimi:**

-Me kërkesë për transaksion të datës 16.10.2014, është bërë likuidimi i ekspertëve kontabël ..... dhe ....., për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë “Ujësjiellës kanalizime” sh.a Lushnjë për vitin 2013, sipas faturës nr. 31, datë 18.05.2014. Likuidimi është kryer për punë të pa realizuar (ka mospërputhje midis orëve të angazhimit dhe orëve të faturuar), duke përfituar padrejtësisht **vlerën 118,800 lekë** nga ekspertët .....dhe ..... (Trajtuar më hollësisht në faqet 56-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i **vlerës 118,800 lekë** nga ekspertët .....dhe ..... Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht, për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë “Ujësjiellës kanalizime” sh.a Lushnjë për vitin 2013, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjiellës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

**Brenda datës 30.06.2016**

## **9. Gjetje nga auditimi:**

Mbështetur në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, për mos regjistrim brenda afatit të shoqërisë “Ujësjiellës kanalizime” sh.a Lushnjë pranë kësaj Qendre, si dhe mos dërgim në kohë të pasqyrave financiare, kjo qendër me shkresat nr. 1233 prot, datë 05.02.2013 dhe shkresën nr. 2793 prot, datë 21.03.2013, ka gjobitur shoqërinë “Ujësjiellës kanalizime” sh.a Lushnjë **me vlerë 30,000 lekë**, gjoba këto të paguara nëpërmjet BKT, me transaksionin nr. 9, datë 06.02.2013 dhe nr. 22, datë 26.03.2013 (Trajtuar më hollësisht në faqet 56-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të analizohet **vlera 30,000 lekë**, që përfaqëson gjoba të paguara nëpërmjet BKT, me transaksionin nr. 9, datë 06.02.2013 dhe nr. 22, datë 26.03.2013, për arsye të mos regjistrimit brenda afatit të shoqërisë “Ujësjiellës kanalizime” sh.a Lushnjë pranë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe mos dërgim në kohë të Pasqyrave Financiare, si dhe të merret vendimi përkatës për zhdëmtim, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjiellës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

**Brenda datës 31.03.2016**

## **10. Gjetje nga auditimi:**

Me urdhërpagesën (Tërheqje Cash) nr. 1, datë 12.02.2013, është tërhequr nga ....., vlera 113,400 lekë, për likuidimin e faturës nr.14, datë 31.01.2013 “Drekë festive e Vitit të Ri 2012”, për 63 person x 1,800 lekë për person. Ky shpenzim është kryer në kundërshtim me pikën 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 849, datë 06.12.2012, për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” (Trajtuar më hollësisht në faqet 56-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të analizohet **vlera 113,400 lekë**, që përfaqëson shpenzim për drekë festive të Vitit të Ri, 2012 në vlerën 113,400. Ky shpenzim është kryer në kundërshtim me pikën 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 849, datë 06.12.2012, për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, si dhe të merret vendimi përkatës për zhdëmtim.

**Brenda datës 31.03.2016**

### **3. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga shoqëria ..... me objekt “Zëvendësimi i tubacionit DN 500 mm me tubacion gize feroidale DN 250 mm në sheshin para Bashkisë Lushnjë”, viti 2014, u konstatua se dokumentacioni teknik i zbatimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit nuk është i plotë dhe i saktë, duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të shoqërisë “Ujësjetës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetit të shtetit në **vlerën 326,250 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 65-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 326,250 lekë**, nga shoqëria ....., për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Zëvendësimi i tubacionit DN 500 mm me tubacion gize feroidale DN 250 mm në sheshin Bashkisë Lushnjë”, viti 2014.

**Brenda datës 30.06.2016**

### **11. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Moto-gjenerator saldimi ”, viti 2014, me shoqërinë ..... shpk Tiranë, u konstatua se dokumentacioni që shoqëron pajisjen me **vlerë 1,020,000 lekë**, nuk është i plotë dhe i saktë.

Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jepte opinion e Tij, për saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit që shoqëron pajisjen si: Autorizim prodhuesi, test raporti i fabrikës, fatura e furnitorit, certifikatën e siguracionit, certifikata e garancisë, dokumentin e transportit (CMR), listë paketimin etj, që të konfirmohet që kjo pajisje është e njëjtë me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën shoqëria ..... shpk Tiranë ka fituar tenderin dhe është likuiduar (Trajtuar më hollësisht në faqet 65-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë::**

-Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë marrë pjesë në kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të pajisjes), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjes, që të konfirmohet që kjo pajisje është e njëjtë me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), si dhe të verifikojë gjendjen e sajë teknike pas vendosjes në punë, nëse kanë qenë ose jo problematike.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisja e furnizuara nga shoqëria .....shpk Tiranë, nuk është autentike, nuk është konform specifikimeve teknike të përcaktuar në procedurën e tenderimit, dhe gjendja e sajë teknike pas vendosjes në punë ka qenë problematike (defekte etj), **konsiderohet dëm ekonomik** dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **arkëtimi i vlerës 1,020,000 lekë** nga shoqëria .....shpk Tiranë. Kjo çështje do të verifikohet nga KLSH, në vijimësi në programet e zbatimit të rekomandimeve dhe në auditimin e radhës.

**Menjëherë**

### **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës neni 14, kontratave individuale të punës, neni 7, i kërkojmë Këshillit Mbikqyrës dhe Administratorit të Shoqërisë, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

**C/I.** Këshilli Mbikëqyrës të analizojë punën e Administratorit të Shoqërisë .....dhe të merren masat e nevojshme administrative dhe disiplinore në përputhje me statutin e shoqërisë, sipas shkeljeve ligjore dhe përgjegjësiive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës së tij, si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë.

### **C/II. “Zgjidhje të kontratës së punësimit”**

**1.** ....., me detyrë ekonomist i masave shtrënguese dhe i policisë ujore.

Për arsye se;

- për periudhën 2014 dhe 8-mujorin 2015, ka ndërprerë dhe rilidhur vetëm 71 debitor familjar, nga 11,318 debitor familjar në vlerën 154,369,227 lekë, si dhe nuk ka kryer asnjë veprim për arkëtimin e detyrimeve, fakt i verifikuar në sistem, çka do të thotë se është realizuar një procedurë formale ndërprerje dhe rilidhje, ndërsa nga 641 debitor të biznesit në vlerën 28,971,298 lekë, 4 debitor me shumicë në vlerën 25,100,449 lekë dhe 37 debitor institucione në vlerën 8,512,769 leke, nuk ka kryer asnjë veprim, si dhe nuk ka aplikuar asnjë gjobë. Gjendja debitore i përket datës 30.08.2015. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, neni 5, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 7697, datë 07.04.1993 “Për kundravajtjen administrative”, i ndryshuar.

-nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Shitjes dhe Departamenti i Projekteve dhe Supervizionit u konstatua se në 39 pallate shumëkatëshe vetëm për 18 janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të pijshëm duke paguar detyrimin financiar, ndërsa në 22 prej tyre nuk janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të pijshëm, pra lidhja nuk është e dokumentuar si është bërë (lidhje e paligjshme, lidhje me miratim verbal etj), duke i krijuar një dëm ekonomik shoqërisë “Ujësijellës Kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetit të shtetit **në vlerën 660,000 lekë.**

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, Metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009, kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”, Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 27.03.2003.

Nga verifikimi i kontratave familjare, të paguara në pallatet e reja shumëkatëshe u konstatua se në 39 pallatet shumë katëshe janë 1886 apartamente gjithsej, nga të cilat për 666 apartamente janë lidhur kontratat me abonentë që i shfrytëzojnë këto apartamente, 674 apartamente janë pa shitur në të cilët janë vendosur matësit e ujit, por nuk ka abonentë që i shfrytëzojnë, ndërsa 533 apartamente shfrytëzohen nga abonent të ndryshëm, faturohet dhe likuidohet uji i pijshëm, por janë të pa kontraktuar, pra nuk është lidhur kontratë me abonentin dhe nuk është paguar detyrimi në vlerën 8000 lekë për çdo kontratë.

Në total detyrimi që nuk i është paguar shoqërisë “Ujësijellës kanalizime” sh.a Lushnjë është **në vlerën 9,656,000 lekë**, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësijellës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”,

i ndryshuar, Metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009, kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”, Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 27.03.2003 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **C/III. “Zgjidhje të kontratës së punësimit”**

ose

#### **“Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate” për:**

**1.** ....., me detyrë ing. i monitorimit dhe mirëmbajtjes në Departamentin e Projekteve dhe Supervizionit.

Për arsye se në 39 pallate shumëkatëshe, vetëm për 18 janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të pijshëm duke paguar detyrimin financiar, ndërsa në 22 prej tyre nuk janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të pijshëm, pra lidhja nuk është e dokumentuar si është bërë (lidhje e paligjshme, lidhje me miratim verbal etj), duke i krijuar një dëm ekonomik shoqërisë “Ujësjellës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetit të shtetit **në vlerën 660,000 lekë**.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, Metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009, kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”, vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 27.03.2003 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.** ....., me detyrë përgjegjës i sektorit të shpërndarjes së ujit për periudhën 02.12.2011 dhe në vazhdim.

Për arsye se:

-Nuk janë kryer analizat e përbërjes fiziko-kimike të ujit të pijshëm për çdo pus, për të përcaktuar trajtimin kimik të ujit të pijshëm, për të bërë të mundur në këtë mënyrë furnizimin e popullatës, biznesit, industrisë dhe institucioneve me ujë brenda standardit shtetëror. Për pasojë nuk mund të gjykohet mbi respektimin e standardin shtetëror të furnizimit me ujë të pijshëm në zbatim të VKM Nr. 145, datë 26.02.1988 “Për miratimin e rregullores higjieno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”.

-Shoqëria nuk ka realizuar plotësisht mbrojtjen higjieno-sanitare të rezervuarëve, depove të ujit dhe rrjetit shpërndarës deri tek përdoruesi, në zbatim të Ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 57 dhe VKM nr. 145, datë 26.02.1998 “Për miratimin e rregullores higjieno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”.

-Me qëllim që të ruhet cilësia e ujit të burimit, shoqëria duhet të kishte caktuar zonat e mbrojtjes sanitare të burimit sipërfaqësor ose nëntokësor të ujit. Kufijtë e këtyre zonave dhe rregullat që duhen respektuar lidhur me to, duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore", Ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” neni 57 dhe rregulloren higjieno-sanitare për ujin e pijshëm të Ministrisë së Shëndetësisë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 119-121, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.** ....., me detyrë përgjegjës i sektorit të KUZ për periudhën 02.12.2011 e në vazhdim.  
Për arsye se:

Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” sh.a Lushnjë , nuk ka planshetet e shkarkimit të ujërave të ndotura, primare dhe sekondare.

-Nga kjo shoqëri, nuk është kryer asnjë analizë ujërave të ndotura, për pasojë nuk mund të gjykohet për zbatimin e standardeve shtetërore.

Nga kjo shoqëri nuk është mbajtur:

-Ditari i regjistrimit të të dhënave të prodhimit të grumbullimit, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura urbane, komerciale dhe industriale.

-Regjistri i vlerësimit, në lidhje me shkarkimet e ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, të prodhuara në pronat respektive (firma të ndryshme), duke pasur parasysh sasinë, karakteristikat dhe cilësinë e tyre.

-Regjistrin e ujërave të ndotura që nuk mund të shkarkohen në sistemin publik të kanalizimeve (komerciale dhe industriale), vend mbajtja e tyre dhe largimi në mënyre legale dhe të autorizuar.

-Regjistri i heqjes së llumit nga gropat septike, gropat e banjave, dhe procedura e ndjekur sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU-ja.

-Nga kjo shoqëri, nuk është kryer monitorimi i shkarkimeve të ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjiellës-kanalizimeve sh.a”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zoonimit të mjediseve ujore pritëse (*Trajtuar më hollësisht në faqet 119-121, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për personat e përmendur më sipër, Administratori i Shoqërisë, sipas shkeljeve ligjore dhe përgjegjësi respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës së tyre, si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë, mund të aplikoj një nga dy masat e rekomanduara.

#### **C/IV “Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate” për:**

**1.** ....., me detyrë punonjës i policisë ujore

**2.** ....., punonjës i policisë ujore

Për arsye se;

-për periudhën 2014 dhe 8-mujorin 2015, kanë ndërprerë dhe rilidhur vetëm 71 debitor familjar, nga 11,318 debitor familjar në vlerën 154,369,227 lekë, si dhe nuk kanë kryer asnjë veprim për arkëtimin e detyrime, fakt i verifikuar në sistem, çka do të thotë se është realizuar një procedurë formale, ndërsa nga 641 debitor të biznesit në vlerën 28,971,298 lekë, nga 4 debitor me shumicë në vlerën 25,100,449 lekë dhe 37 debitor institucione në vlerën 8,512,769 leke, nuk kanë kryer asnjë veprim, si dhe nuk është aplikuar asnjë gjobë. Gjendja debitore i përket datës 30.08.2015. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, neni 5, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 7697, datë 07.04.1993 “Për kundravajtjen administrative”, i ndryshuar.

-në 39 pallate shumëkatëshe vetëm për 18 janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të pijshëm duke paguar detyrimet financiar, ndërsa në 22 prej tyre nuk janë miratuar pikat e lidhjes së ujit të



pijshëm, pra lidhja nuk është e dokumentuar si është bërë (lidhje e paligjshme, lidhje me miratim verbal etj), duke i krijuar një dëm ekonomik shoqërisë “Ujësjetllës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetit të shtetit **në vlerën 660,000 lekë**.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, Metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009, kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”, vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 27.03.2003. -në të 39 pallatet shumë katëshe janë 1886 apartamente gjithsej, nga të cilat për 666 apartamente janë lidhur kontratat me abonentë që i shfrytëzojnë këto apartamente, 674 apartamente janë pa shitur në të cilët janë vendosur matësit e ujit, por nuk ka abonentë që i shfrytëzojnë, ndërsa 533 apartamente shfrytëzohen nga abonent të ndryshëm, faturohet dhe likuidohet uji i pijshëm, por janë të pa kontraktuar, pra nuk është lidhur kontratë me abonentin dhe nuk është paguar detyrimi në vlerën 8000 lekë për kontratën.

Në total detyrimi që nuk i është paguar shoqërisë “Ujësjetllës kanalizime” sh.a Lushnjë është në vlerën 9,656,000 lekë , vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjetllës kanalizime sh.a Lushnjë dhe dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” , i ndryshuar, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, Metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009, kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”, vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 27.03.2003(*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **C/V "Vërejte" për:**

1. ...., me detyrë shefe e departamentit të shitjes për periudhën 09.04.2014 dhe në vazhdim.
2. ...., me detyrë faturiste
3. ...., me detyrë faturiste
4. ...., me detyrë faturiste
5. ...., me detyrë faturiste
6. ...., me detyrë faturiste
7. ...., me detyrë faturiste

Për arsye se;

-në të 39 pallatet shumë katëshe janë 1886 apartamente gjithsej, nga të cilat për 666 apartamente janë lidhur kontratat me abonentë që i shfrytëzojnë këto apartamente, 674 apartamente janë pa shitur në të cilët janë vendosur matësit e ujit, por nuk ka abonentë që i shfrytëzojnë, ndërsa 533 apartamente shfrytëzohen nga abonent të ndryshëm, faturohet dhe likuidohet uji i pijshëm, por janë të pa kontraktuar, pra nuk është lidhur kontratë me abonentin dhe nuk është paguar detyrimi në vlerën 8000 lekë për kontratë.

Në total detyrimi që nuk i është paguar shoqërisë “Ujësjellës kanalizime” sh.a Lushnjë është në vlerën 9,656,000 lekë, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjellës kanalizime sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, Metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009, kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”, vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 27.03.2003 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Shënim**

Për punonjësit që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune: ....., ....., Dritan ....., ....., ....., ....., ....., ....., ....., ....., dhe ....., të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjë prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave, nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të konsiderueshme në mirëfunksionimin e shoqërisë, konsiderojmë që për to, të mos propozohet masë.

Për: ....., ..... dhe ....., të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar, rezultojnë se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Për këta punonjës nuk është propozuar masë disiplinore, pasi masa ndaj tyre konsiderohet e ezauruar. Masa e propozuar do të ishte **“Zgjidhje të kontratës së punësimit”ose “Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate”.**

Për:

-....., me detyrë ish-kryetari këshillit mbikëqyrës, masa e propozuar këshillit bashkiak (asamblesë së aksionerëve), **do të ishte shkarkim si antar i Këshillit Mbikëqyrës.**

-....., me detyrë ish-administrator i UK Lushnjë për periudhën 19.07.2007 deri më 13.05.2010 masa e propozuar Këshillit Mbikqyrës, **do të ishte zgjidhje e kontratës së punësimit.**

-....., me detyrë ish-administrator i UK Lushnjë për periudhën 14.05.2010 deri më 22.08.2011 masa e propozuar Këshillit Mbikqyrës, **do të ishte zgjidhje e kontratës së punësimit.**

Ç. Në lidhje me shkeljet e konstatuara më sipër, ti kërkohet Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Zbatimit të Standarteve në KLSH, që në shqyrtim të gjetjeve të këtij auditimi, të vlerësojë dhe përgatisë materialet përkatëse ose të gjithë materialin që do ti përcillen organit të Prokurorisë si indicie për ekzistencën e elementëve të figurës së veprave penale.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit Fatmir Iliazi, Skender Hajdari, Gerti Bode dhe Orgest Levani, më tej u shqyrtua nga k/auditues Yllka Pulashi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.